


REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT

OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

Nr i kontrates 651-23-10934-2-1-1/C578

KUVENDI KOMUNAL- GJILAN, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;

Dhe N.N.SH. " Vizion Project ", K.e Diellit Bl. IV H.IV, PRISHTINË, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për Shërbimet në vijim:

Hartimi i projekteve për ndërtime të larta në Komunën e Gjiçilanit me numër identifikues: 651-23-4059-2-1-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim: **sipas sasive të përshkruara në aneksin nr. 1 të dosjes së tenderit si dhe paramasës.**

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i(të) detyruar të përdorë(in) këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurorin shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me **datën e nënshkrimit nga te dy palët dhe përfundon në afat prej 36 muajve.**

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë **sipas Kushteve të Veçanta të kontratës pika 17.1** nga koha e lëshimit të urdhër bërjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë **Në Komunën e Gjiçilanit**

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

3.1 Kjo Kontratë Kornizë është e lidhur me çmime për Njësi dhe do të realizohet deri në vlerën e parashikuar. Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Vlera e parashikuar e kontratës është : 150.000.00Euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë. 3.3 Çmimet e njësisë do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve); **18.07.2023**
- (f)

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.





5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	Kujtim Bajrami	Emri:	Shkelqim Osmani
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	16.08.2024	Data:	16.08.2024
Vula:		Vula:	

KUSHTET E VEÇANTA


KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbuloohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë Gjykata Themelore – Departamenti për Çështje Ekonomik në Prishtinë
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit, me vendim të veçantë, do të emërohet nga ZKA i A.K., ditën e nënshkrimit të kontratës me Operatorin Ekonomik
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurimit të Ekzekutimit është 10% e vlerës së parashikuar me afat validitetit prej 37 mujve nga data e nënshkrimit të kontratës
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Rreziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të jenë: <ul style="list-style-type: none"> a) Mjetet motorike të Palës së Tretë <i>[shëno shumen]</i> b) Përgjegjësia e pales së tretë <i>[shëno shumen]</i> c) Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve <i>[shëno shumen]</i> d) Përgjegjësia profesionale: deri 100 % të vlerës së Sigurimit të Ekzekutimit. Humbje ose dëmtim të pronës dhe pajisjeve :
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: <p>Hartimi i projektit Ideor dhe Kryesor – Zbatues do të bëhet vetëm në bazë të kërkesës porosisë me shkrim të lëshuar nga Menaxheri i kontratës i Autoritetit Kontraktues.</p> <p>Hartimi i projektit do të bëhet vetëm në konsultim të ngushtë me Menaxherin e Projektit të Autoritetit Kontraktues dhe organet tjera relevante që kanë interes nga ky aktivitet, që në të shumtën e rasteve do të jetë drejtuesi i Njesisë Kërkuese – Drejtori i Drejtorisë përkatëse.</p> <p>Për cdo projekt ideor dhe kryesor duhet të behet prezentimi</p>

		<p>para investitoreve, prezentimi do të behet në komunë dhe do të organizohet nga drejtoria përkatëse komunale, në të cilin organizim mund të marrin pjesë edhe banorët e lokaliteti dhe palët me interes.</p> <p>Operatori Ekonomik hartimin e cdo projekti duhet ta bëjë duke dale në terren (të beje rivelimin e terrenit), për viziten e tije ne terren duhet paraprakisht ta lajmëroj investitorin dhe menaxherin e kontratës së paku 24 ore para vizitës së planifikuar nga kompanija hartuese.</p> <p>Afati Kohor i shprehur në ditë kalendarike, për hartimin e projekteve nga data e lëshimit të porosisë dhe detyrës projektuese nga Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues është si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> Për Projektet Ideore 15 ditë, nga data e pranimit të porosisë, të lëshuat nga Menaxheri i Projektit i Autoriteti kontraktues; Për Projekteve Kryesore 30 ditë, nga data e pranimit të porosisë, të lëshuat nga Menaxheri i Projektit i Autoriteti kontraktues; dhe Për Projektet e Elaborateve 15 ditë, nga data e pranimit të porosisë, të lëshuat nga Menaxheri i Projektit i Autoriteti kontraktues.
		<p>Pranimi i projektit do të bëhet përveç nga Menaxherit të Kontratës edhe nga një Komision profesional i emëruar nga Zyrtari Kryesorë Administrativ i Autoritetit Kontraktues.</p> <p>Projekti konsiderohet i kryer vetëm pas pranimit nga ana e komisionit profesional, i cili me rastin e pranimit përpilon raportin duke konstatuar pranimin apo jo të projektit.</p>
		<p>Pagesa për hartim të projektit do të bëhet vetëm nën kushte nëse është kryer, projekti Ideor, Projekti Kryesor apo Elaborati duke marrë për bazë çmimet respektive në ofertën financiare të Kontraktuesit.</p> <p>Pagesa do të kryhet brenda afatit sa më të shkurtër kohor por jo më gjatë se 30 ditë nga data e pranimit dhe protokolimit të faturës nga zyrtari përgjegjës i AK. për pranimin e faturave.</p>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatës Themelore – Departamenti për Çështje Ekonomike në Prishtinë, në pajtim me ligjin në Kosovë.

SPECIFIKIMI I TIPEVE TË PROJEKTEVE PËR TË CILËT DUHET HARTUAR DOKUMENTACIONET INVESTIVO-TEKNIKE - PËR OBJEKTE NËDERTIMORE


Pozicioni	Emri i objektit ndërtimor	Lloji i objektit ndërtimor	Tipi i objektit	Mësimi	Sasia	Projekt i kryesor - Çmimi në € me tvsh për/njësi										Çmimi total
						Arkitekturë	Shtetë	Elektrikë	Kanalizim dhe ujësjellës	Elaborat i kunders zierit	Nx. qendrore	Raporti i mbrojtjes së mjedisit	Totali i cimit për njësi me tvsh			
I	SOCIALE	Shtëpi e pleqëve, banimit social, konvikte për nxenes dhe student etj.	Ndërtim i ri	m ²	1.00	h	i	j	k	l	m	n	1.40	4.20		
						0.80	0.20	0.10	0.10	0.05	0.10	0.05				
	KULTURORE	Shtëpi të kulturës	Rindërtim	m ²	1.00	h	i	j	k	l	m	n	1.40	4.20		
						0.80	0.20	0.10	0.10	0.05	0.10	0.05				
II	ADMINISTRATIVE	Administratë, zyre të vendit	Riparim -Renovim	m ²	1.00	h	i	j	k	l	m	n	1.40	1.80		
						0.80	0.20	0.10	0.10	0.05	0.10	0.05				
III	SPORTIVE	Palestrat sportive, hallat sportive , stacione etj.	Ndërtim i ri	m ²	1.00	h	i	j	k	l	m	n	1.10	1.80		
						0.50	0.20	0.10	0.10	0.05	0.10	0.05				
		Të tipit të hapur- terrenet sportive	Ndërtim i ri	m ²	1.00	h	i	j	k	l	m	n	0.70	3.10		
						0.20	0.10	0.10	0.10	0.05	0.10	0.05				
IV	EKONOMIKE	Vendpikëngje , tregje të tipit të hapur, tregje e tipit të mbyllur, kiosqe, objekte të zjarritkëve, garazha, depo etj	Riparim -Renovim	m ²	1.00	h	i	j	k	l	m	n	0.26	2.20		
						0.20	0.01	0.01	0.01	0.01	0.01	0.01				
		Sip. të gjelbërta , parqe, sheshe, varreza, hapësira rekreative, vende pushimore etj.	Ndërtim i ri	m ²	1.00	h	i	j	k	l	m	n	1.95	2.20		
						1.80	0.10	0.01	0.01	0.01	0.01	0.01				
V	HAPËSIRA PUBLIKE	Sip. të gjelbërta , parqe, sheshe, varreza, hapësira rekreative, vende pushimore etj.	Riparim -Renovim	m ²	1.00	h	i	j	k	l	m	n	0.25	2.20		
						0.19	0.01	0.01	0.01	0.01	0.01	0.01				
						h	i	j	k	l	m	n	1.95	2.20		



VËRETTJE:	<p>Sasitë e paraqitura janë për 36 muaj, dhe ato mbeten të pa ndryshuara.</p> <p>Ofertuesit janë të obliguar që ta plotësojnë çdo rubrikë të paraqitur për vendosjen e çmimeve për njësi. Nëse në rubrikat e caktuara nuk është plotësuar oferta financiare, atëherë e njëjta do të llogaritet jo valide dhe ofertuesi do të diskualifikohet.</p> <p>Çmimi në € për njësi të sipërfaqes në m² të bëhet në hapësirat bruto të çdo etazhe (vetëm për objekte etazhe).</p> <p>Themelëti të llogariten 50% të sipërfaqes së shfrytëzueshme si dhe 50% të sipërfaqes së kullimit.</p> <p>Në kuadër të çmimit të jenë të llogaritura taksat dhe tatimet e aplikuar në Republikën e Kosovës (DDP)</p> <p>Në kuadër të të gjitha pozicioneve të lartëcekura kompania fituese obligohet që të kryej shqyrtimet gjeomelanike për objektet e kategorisë së II-të të bëhet elaborati kundër zjarrit si dhe raporti për mbrojtjeje të mjedisit</p> <p>Në kuadër të të gjitha pozicioneve të lartëcekura kompania fituese obligohet që të siguroj rielvimin e terrenit</p> <p>Projektet dorëzohen në 5 kopje të printuara si dhe në kopje elektronike - CD (për dhe dwg) file duke respektuar rregullat e ligjore deri në paisje të investitorit - pronarit me leje të ndërtimit.</p> <p>Të gjitha çmimet e specifikuar në tender duhet të deklarohen në Euro (€). Çmimi i ofertuar lejohet që të shprehohet me maksimum dy (2) numra pas presjes dhjetore. Çdo numër i shprehur pas numrit të dyte (2) nuk do të merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës, oferta e tillë do të konsiderohet e pa përgjegjeshme</p>
------------------	---

REKAPITULLIMI				
Nr.	Emri i objektit ndërtimor	Peshimi në %	Çmimi total	Çmimi i peshuar
I	SOCIALE ARSIMORE KULTURORE SHËNDETËSORE ADMINISTRATIVE	60%	4.20	2.52
II	OBJEKTET SPORTIVE	10%	1.80	0.18
III	OBJEKTET SPORTIVE	10%	3.10	0.31
IV	OBJEKTET EKONOMIKE	10%	2.20	0.22
V	HAPËSIRA PUBLIKE	10%	2.20	0.22
Totali:				3.45

Çmimi i Përgjithshëm i peshuar (ofertat do të vlerësohen në bazë të kesaj vlerë). Kjo është vlera e cila do të duhet të shprehohet në Formularin e ofertës dhe do të lexohet gërite hapjes publike.





ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. **129595**

Për **KOMUNA E GJILANIT**

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **Shkelqim Osmani B.I.**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Hartimi i projekteve për ndërtime të larta në Komunën e Gjilanit me numër identifikues**

Nr. prokurimit: 651-23-4059-2-1-15 , Nr. brendshëm: Nr i kontrates 651-23-10934-2-1-1/C578

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t`i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **15,000.00€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **15,000.00€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 1125 ditë kalendarike prej **16.08.2024** deri më **15.09.2027**

Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit të Garancionit, Siguruesit/Garantuesit i kalon e drejta për ta rimbursuar nga i Siguruari/Kontraktuesi shumën e paguar përfituesit, me të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore deri në përmbushjen e tërësishme të detyrimeve.

Data lëshimit: 16.08.2024

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.



REPUBLIKA E KOSOVËS

NOTER
SEFER KRASNIQI
LIPJAN

LRP.nr. 3150/2024

Sot, më datë njëzet e tre maj dymijë e njëzet e katër (23.05.2024), para meje Sefer Krasniqi, Noter në Lipjan Rr. "Shqipëria", Nr.51 me kërkesë që t'ia përpilojë aktin noterial prokurë e përgjithëshme është paraqitur:-----

N.N.SH. "Vizion Project" me numër unik identifikues 810540345, me adresë në rruga "Ukshin Kovaçiva" Ll.3, Ll-C nr.1 Prishtinë e regjistruar në MTI me datë 03.03.2008 e përfaqëson Shkelqim Osmani, i lindur në Runik, më datë 07.06.1981, me numër personal 1021551097, me vendbanim në Prishtinë, shtetas i Republikës së Kosovës, identitetin e të cilit e kam vërtetuar nëpërmjet letërnjoftimit me nr.ID1684484 lëshuar nga MPB Republika e Kosovës me datë 28.10.2020 me afat vlefshmërie deri me datë 27.10.2030, në tekstin e mëtejme Autorizuesi.-----

Pasi që vërtetova se pala ka zotësi për të vepruar, bindjes se është duke shprehë vullnetin e--- lirë dhe pas sqarimit të dhënë për efektet dhe pasojat e këtij veprimi juridik, pala e cekur dha këtë -----


PROKURË E PËRGJITHËSHME

Unë Shkelqim Osmani në emër dhe për llogari të ndërmarrjes N.N.SH. "VIZION PROJECT" e Autorizoj:-----

Perparim Osmani, i lindur në Runik, më datë 19.06.1986, me numër personal 1173351557, me vendbanim në Prishtinë, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme si vijon: -----
Të përfaqësoj ndërmarrjen N.N.SH. "VIZION PROJECT" dhe në emër të saj të lidh marrëveshje dhe të nënshkruaj kontrata me palët e treta para organeve zyrtare si para noterit, apo organeve tjera shtetërore, si dhe personave privat apo ndërmarrjeve, ta përfaqësoj në të gjitha organet shtetërore, Ministrinë, Komunën dhe para çdo Gjykate në Republikën e Kosovës duke më përfaqësuar me të gjitha të drejtat që unë i posedoj si drejtor dhe pronar i kësaj ndërmarrje sikur të isha vet personalisht pa asnjë kufizim nga ana ime. I autorizuari përveq tjerash mund të më përfaqësoj në doganën e Republikës së Kosovës në të gjitha pikat doganore me të drejtë të regjistroj ndërmarrjen për eksport-import në doganën e Kosovës, zhdoganimit të mallit në emër të kësaj ndërmarrje, përfaqësimin në administratën tatimore të Kosovës dhe cilindo institucion tjetër të administratës të Republikës të Kosovës dhe për cilëndo punë apo veprim që ka nevojë ndërmarrja në fjalë. -----

I autorizuari ka të drejtë të kryej të gjitha punët dhe pagesat, të hap llogari bankare, të terheq kartelen bankare, mjete apo të paguaj borgje në bankat e Republikës së Kosovës, të nënshkruaj kontrata në emër të ndërmarrjes me cilëndo palë të tretë sikur të isha unë vet, në bankat si:TEB, BKT, Raiffeisen Bank, NLB,BPB dhe gjitha bankat tjera që operojn në RKS.-----

Që të bëjë shitblerjen e paluajtshmerisë si tokë, banesë, villë apo lokal në cilëndo zonë kadastrale dhe të i regjistroj ato në emër të firmes. I autorizuari ka të drejtë të paraqitet në Drejtoratin për Gjeodezi dhe Kadastër të aplikoj me kërkesë për nxjerrjen e fletes poseduese dhe kopjen e planit, të bëj pagesat e taksës komunale, të nënshkruaj në emrin tim dhe të ngrit ankesë në rast nevojë, të kujdeset për nxjerrjen e çfarëdo dokumenti lidhur me paluajtshmeri.



Handwritten signature

Të përgadis projektin konceptual dhe kryesor për objektin ndërtimor, me të drejt që të aplikoj për kushtet urbanistike dhe leje ndërtimi pran DPUMM, si dhe në DGJK, si dhe pëlqime tjera për infrastruktur në organet përkatëse kompetente, me të drejtë që të rregulloj dokumentacionin përkatës.-----

I autorizuari ka të drejtë ta përfaqësoj ndërmarrjen N.N.SH. "VIZION PROJECT" para çdo ndërmarrje publike në Republikën e Kosovës siç janë: KEDS, PTK, ARRT, ujit mbeturinat, gjithashtu ka të drejtë të nënshkruaj autorizimet për ngasje të veturave, kontratë për shitblerjen e tyre, regjistrimin, ç'regjistrimin, ka të drejt të nënshkruaj kontratat për shitblerjen e produkteve të cilat lidhen me veprimtarinë e ndërmarrjes në fjalë, gjithashtu ka të drejtë që të përfaqësojë ndërmarrjen edhe pranë Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve (ARBK). Të nënshkruja kontrata të punës me punonjësit e kompanisë, marrëveshjes sponsorizimi me autoritetet kontraktuese që lidhen me veprimtarinë e biznesit, të dorëzoj, nënshkruaj dhe pranojë çfarëdo dokumenti pranë cilitdo organ duke përfshirë ARBK, ATK, Gjykata, Administrata, Komuna etj. Të përfaqësojë kompaninë pranë organeve kompetente në të gjitha procedurat kontestimore dhe jokontestimore. -----

Të gjitha veprimet të cilat i ndërmerr i autorizuari i konsideroj si veprime të miat.-----
I autorizuari ka të drejtë të nxjerr cilin do dokument që kërkohet nga organet e Republikë së Kosovës. I autorizuari mund ta bartë këtë autorizim te personat e tjerë. Ky Autorizim vlen me afat të pacaktuar deri në ditën e revokimit të tij nga ana e autorizuesit.-----

Njoftimet: Ky akt noterial është përpiluar në përputhje me dispozitat e neneve 33, 34, 35 dhe 40 të Ligjit për Noterin NR.06/L-010. Konstatohet se ky akt noterial ka 2 fletë me 4 faqe, prej të cilave 2 faqe të shkruara dhe në original i është dhënë Autorizuesit-----

Kompensimi dhe shpenzimet e Noterit janë llogaritur dhe paguar në shumë prej 10.00 euro, për lidhjen e aktit noterial 1.00euro, për fotokopjen e shkresave 1.00 euro, gjithsej 12.00 euro + 18% TVSH, në pajtim të nenit 23 par. 8 të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2022 për Tarifat Noteriale. -----

Lipjan, më datë njëzet e tre maj dymijë e njëzet e katër (23.05.2024) ora 11;21-----

AUTORIZUESI: N.N.SH. "VIZION PROJECT" -----

Shkelqim Osmani

Shkelqim Osmani



NOTERI

Shkelqim Osmani



